

V E N D I M
Nr. 98, datë 15.3.1994

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.274, DATË 12.6.1993" PËR KOMPESIMIN E BUKËS PËR FRYMË TË SHPENZIMEVE NGA RRITJA E ÇMIMIT TË BUKËS"

Me propozimin e Ministrisë së Punës, të Emigracionit dhe të Përkrahjes Sociale dhe të Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.274, datë 12.6.1993 "Për kompesimin për frymë të shpenzimeve nga rritja e çmimeve të bukës", në kreun III, pika 5, shkronja "a" ndryshohet si vijon:

"Nga buxheti i shtetit për ndërrmarjet dhe inistucionet shtetërore buxhetore, për pensionistët, për punonjësit që përfitojnë përkrahje sociale, vetëm për pjesën e ngarkesës që i takon në familje, 214 lekë në muaj për frymë.

Nga buxheti i shtetit për ndërrmarjet dhe inistutucionet shtetërore jobuxhtore, për personin dhe për pjesën e ngarkesës që i takon në familje për periudhën 1 janar-31 mars, dhe vetëm për personin e punësuar për periudhën 1 prill-30 qershor.

Duke filluar nga data 1 korrik, kompesimi nga rritja e çmimit të bukës do të përballohet tërësiht si për personat në punë, ashtu edhe për ngarkesën nga vete ndërrmarjet dhe inistutucionet jobuxhetore".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi